



Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16, 164/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 190/19), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 03/2020

për dorëzimin e kërkesave për pagesë të mjeteve dhe për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në Peshkatarin dhe Akuakulturë për vitin 2020

I. LËNDA E SHPALLJES PUBLIKE

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për nenpikat për masat në vijim:

Masa 1	Përkrahja financiare në peshkatarin	Mjetet	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 1.3	Pikat e peshkimit-ndërtimi i të rejave, rikonstruimi dhe adaptimi i pikave ekzistuese të peshkimit, kompensim i shërbimit për shfrytëzim të pikave ekzistuese	1.000.000,00 denarë	1.000.000,00 denarë, gjegjësisht 100% nga vlera e investimit ose kompensim i shërbimit
Nënpika 1.4	Përkrahje financiare për rehabilitim të ujërave për peshkim me zgjerim, mbindërtim dhe pajisje e kapaciteteve ekzistuese/baseneve për prodhim e materialit riprodhues dhe materialit për kultivimin e peshqve.	1.500.000,00 denarë	1.500.000,00 denarë, gjegjësisht 100% nga shpenzimet e pranuar/miratuara
Nënpika 1.5	Ndërtimi dhe rikonstruimi mandrave për peshkim tradicional në liqenin e Dojranit	1.000.000,00 denarë	1.000.000,00 denarë, gjegjësisht 100% nga shpenzimet e pranuar/miratuara
Nënpika 1.6	Mbrojtje plotësuese e peshqve në ujërat e peshkimit	- deri 30.000 denarë për mbrojtjen e rivierave të peshkimit dhe zonave rekreative - deri 150.000 denarë për mbrojtjen e zonave të peshkimit - deri 400.000 denarë për mbrojtjen e rajoneve të peshkimit	

Masa 2	Përkrahja financiare në akuakulturë	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 2.2	Mbështetje financiare për materialet për kultivimin e peshqve	- 40% nga vlera e të rinjve të furnizuar ose të tyre

II. SHFRYTËZUES

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve sipas nënpikave kanë:

Subjektet	Nënpika
Njësi të vetëqeverisjes lokale për ndërtimin e pikave të reja, rikonstruimi dhe adaptimin e pikave ekzistuese për peshkim, ndërsa shfrytëzues të mjeteve për kompensim për shërbim për shfrytëzim të pikave ekzistuese janë koncesionerë të peshkut.	1.3
Reproqendra të regjistruara për prodhim të materialit reprodaktiv dhe materialit për kultivimin e peshqve	1.4
Njësia e vetëqeverisjes lokale ose koncesionerët e peshqve për kryerjen e peshkimit tregtar në Liqenin e Dojranit.	1.5
Koncesionerët e peshqve nga ujërat e peshkimit. Një koncesioner mund të shfrytëzojë mjetet vetëm për një periudhë të caktuar të shumimit natyror dhe ndalesës për peshkim	1.6

III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet dedikohen për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, shpenzime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe shpenzime të tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare të peshkatarisë dhe akuakulturës për vitin 2020 (Gaz. Zyrtare nr. 277/19).

Mjetet për nënpikën 1.6 janë të dedikuara për kompensim të shpenzimeve të pranueshme për mbrojtje plotësuese fizike të peshqve e cila bëhet gjatë shumimit natyral të peshqve i përcaktuar në bazën e peshkimit dhe vendimit të sjellur për ndalesën e peshkimit nëpër ujëra të caktuara të peshkimit për periudhën prej 1 prill deri 15 korrik 2020 edhe atë shpenzime të realizuara për:

- shërbime për persona të tretë (roje të peshqve) për mbrojtje fizike të peshqve por jo më shumë se bruto paga mujore në veprimtari për person të angazhuar
- lëndë djegëse për objektet e lundrimit në pronësi të koncesionerit ose të dhëna për shfrytëzim

- lëndë djegëse për makinat në pronësi ose të dhëna për shfrytëzim
- huazim të objekteve lundruese nga persona të tretë.

Mjetet nga nënpika 2.2 janë të dedikuara për furnizim të materialit për kultivimin e peshqve për mbjelljen e baseneve të peshqve në periudhën prej 1 korrik deri 30 shtator 2020.

Mjetet nga nënpika 2.2 paguhet gradualisht edhe atë:

- për të vegjlit e blerë ose në pronësi deri 2.500 kg - 100% nga vlera e përcaktuar e të vegjëlvë
- për të vegjlit e blerë ose në pronësi prej 2500 kg deri 5000 - 75% nga vlera e përcaktuar e të vegjëlvë
- për të vegjlit e blerë ose në pronësi prej 5000kg deri 7500 - 50% nga vlera e përcaktuar e të vegjëlvë
- për të vegjlit e vlerë ose në pronësi mbi 7500kg - 25% nga vlera e përcaktuar e të vegjëlvë.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat dorëzohen në original.

Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë kërkuesit të mjeteve janë përcaktuar në Programin për përkrahje financiare në peshkatarin dhe akuakulturë për vitin 2020 ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 277/2019).

Nëse në Agjenci dorëzohen më shumë kërkesa sesa ka mjetet në disponim në pajtim me Programin për përkrahje financiare në peshkatarin dhe akuakulturë për vitin 2020, Agjencia do tu japë përparësi atyre kërkuesve që kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

Për nënpikat 1.3, 1.4 dhe 1.5, kërkuesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të kontratës për bashkëfinancim me Agjencionin për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për pagesë" dhe "Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve" (Formular PRA-A1) së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhezimin e shfrytëzuesve mund të merret në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Formularët e lartpërmendur mund të merren dhe drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 16:30 në adresën:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,  
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20  
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)  
1000 Shkup

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për përkrahje financiare dhe pagesën e mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në peshkatarin dhe akuakulturë për vitin 2020 së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS E HAP" për Thirrjen publike nr. 03/2020 dhe shënimin e shifrës së nënpikës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë. Nëse zarfi nuk është i shënuar ashtu siç kërkohet, Agjencia nuk merr përgjegjësi për arrijten jo në kohë ose të pakompletuar për arrijten në arkiv apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve:

Për nënpikën 1.3, 1.4 dhe 1.5 është **30.11.2020**

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pagesë të mjeteve:

Për nënpikën 1.6

- për kryerjen e mbrojtjes plotësuese fizike të peshqve në periudhën prej 1 prill deri 15 korrik 2020, afati i fundit është **30 nëntor 2020**.

Për nënpikën 2.2

- për mbjelljen e baseneve të peshqve në periudhën prej 1 korrik deri 30 shtator 2020, afati i fundit është **30 nëntor 2020**.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim.

Informata më të detajuara në kontakt telefonin (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresë:

[ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe në ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk) ose [www.pa.gov.mk](http://www.pa.gov.mk)

Kontakt:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për miratimin e pagesës.

Telefoni: **02 3097 - 460**, çdo ditë pune prej 08:30 deri në ora 16:30.

E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)